

**FTESË**  
**Konventa Kombëtare për Integrimin Europian**  
**2021 – 2023**

**Grupi i Punës V (Tregtia dhe Çështjet Ekonomike)**

**Sesioni 3, Tema: Barrierat në kuadër të ofrimit të shërbimeve dhe njohja e kualifikimeve profesionale me BE (Kapitulli 3)**

*e martë, 20 tetor 2022, 10:30 – 11:30*

*Online Platforma ZOOM & fizikisht Hotel Rozafa, Salla 1, Shkodër*

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) dhe Slovak Foreign Policy Association në bashkëpunim me Shoqatën e Grave Profesioniste, Afariste e Zejtare të Shqipërisë (SHGPAZ), me mbështetjen financiare të SlovakAid ju fton në Sesionin 3 të Grupit të Punës V (Tregtia dhe Çështjet Ekonomike) “Barrierat në kuadër të ofrimit të shërbimeve dhe njohja e kualifikimeve profesionale me BE (Kapitulli 3)” që po organizohet në kuadër të **Konventës Kombëtare për Integrimin Europian 2021- 2023**.

Konventa fokusohet në 3 drejtime kryesore: 1) rritja e pjesëmarrjes së të gjithë segmenteve të shoqërisë shqiptare (përfshirë edhe nivelin lokal); 2) institucionalizimi i debatit publik në çështjet e BE-së bazuar në bashkëpunimin e institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe ato të biznesit; dhe 3) forcimi i kapaciteteve në negociatat për integrimin në BE përmes transferimit të njohurive sllovaqe.

Në sajë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me ministrinë dhe agjencitë kyçe gjatë periudhës 2014-2021 si Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, janë krijuar disa grupe pune për të adresuar kapitujt më sfidues të negociatave të Acquis së BE-së. Gjatë **Konventës 2021–2023** po organizohen **16 sesione** për katër Grupe Pune, më konkretisht: **GP I** – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore (Kapitulli 23); **GP II** – Drejtësia, Liria, Siguria (Kapitulli 24); **GP III** – Bujqësia dhe Mbrojtja e Konsumatorit (Kapitulli 11, 12 dhe 28); **GP V** – Çështjet e Tregtisë dhe Ekonomisë (Kapitulli 1, 2, 3, 4 dhe 20).

Në kuadër të **Grupit të Punës V** deri më tani janë organizuar 5 sesione me tema dhe fusha që lidhen me lëvizjen e lirë të mallrave dhe standardet për produktet ushqimore, politikat industriale dhe mbështetjen e sipërmarrjes. Për periudhën 2021-2023 janë planifikuar të organizohen katër sesione për këtë GP.

*\*Gjatë aktivitetit do të ofrohet përkthim i gjuhës angleze*

## PROGRAMI

### Konventa Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023

#### Grupi i Punës V (Tregtia dhe Çështjet Ekonomike)

#### Sesioni 3, Tema Barrierat në kuadër të ofrimit të shërbimeve dhe njohja e kualifikimeve profesionale me BE (Kapitulli 3)

*e martë, 20 tetor 2022, 10:30 – 11:30*

*Online Platforma ZOOM & fizikisht Hotel Rozafa, Salla 1, Shkodër*

**10:15 – 10:30**    **Regjistrimi i pjesëmarrësve**

**10:30 – 10:50**    **Fjala e mirëseardhjes – Domosdoshmëria për realizimin e aktiviteteve me qëllim dialogun dhe informimin**

**Nirvana Deliu**, Koordinatore Projekti, Lëvizja Europiane në Shqipëri  
**Flutura Xhabija**, Presidente, SHGPAZ  
**Përfaqësues/e**, Bashkia Shkodër (tbc)

**10:50 – 11:15**    **Ofrimi i shërbimeve dhe barrierat e identifikuara**

**Ondrej Blažo**, Drejtor i Institutit për të Drejtën Europiane në Universitetin Comenius në Bratislavë

- *Legjislacioni i BE për Kapitullin 3 – Çfarë mbulon Direktiva e Shërbimeve dhe si duhet kuptuar ajo*

- *Barrierat për lëvizjen e shërbimeve – zgjidhje dhe praktikat më të mira për të minimizuar këto barriera*

- *Procesi i njohjes së dyanshme të kualifikimeve profesionale – si përfitojnë profesionistët dhe sektorët kryesorë nga ky proces?*

**11:15– 11:30**    **Sfidat që hasin operatorët e biznesit për ofrimin e shërbimeve**

**Komente dhe rekomandime nga ekspertët shqiptarë dhe aktorët kryesorë të këtij sektori**

**11:30**            **Mbyllja e takimit dhe koktejl**

